




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTESIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK DURRES**



Nr 325 prot

Durres, me date 27.2.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr.759 , datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë , menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

Qendra e Formimit Profesional Publik Durres ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet :

1. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Instalim dhe mirembajtje hidraulike " prane QFPP Durres , (1 person)
2. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Mobileri" QFPP Durres , prane IEVP Kavaje (1 person)
3. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Saldim" QFPP Durres , prane IEVP Kavaje, (1 person)
4. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Instalim dhe mirembajtje hidraulike " QFPP Durres , prane IEVP Kavaje (1 person)
5. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Gjuhe e huaj Anglisht" QFPP Durres , prane IEVP Fush-Kruje (1 person)
6. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Gjuhe e huaj Italisht " QFPP Durres , prane IEVP Fush- Kruje (1 person)

7. Instruktor I praktikës profesionale për kursin “Fotografi digjitale” pranë QFPP Durres, (1 person)

2. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formë së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e QFPP Durrës , brenda datës

07.03.2025.

